VENDIM
Nr. 553, datë 22.8.2012

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT TË INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË "EPOKA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5 e 43 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit të institucionit privat të arsimit të lartë "Epoka" nga shkollë e lartë në universiteti privat "Epoka".
2. Ky institucion privat i arsimit të lartë ruan akreditimin institucional dhe të programeve të studimit të fituar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha